



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
DREJTORIA E INTEGRIMIT EVROPIAN KOORDINIMIT DHE INFORMIMIT PUBLIK
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 470/2 Prot.

Patos, më 18/03/2022

PROCES-VERBAL

I mbajtur sot në datë 16.03.2022 ora 14:00 në ambientet e Pallatit të Kulturës Patos, salla e Konferencës zhvillohet dëgjesa publike me grupe interesit “Subjekt Taksi” lidhur mbi “Diskutimin e procedurës për licensimin dhe rilicensimin e mjeteve të shërbimit Taksi 4+1 dhe 8+1” të cilat ushtrojnë shërbimin e tyre në territorin e Bashkisë Patos

Pjesëmarrës në këtë mbledhje janë:

1. Përfaqësues të shërbimit taski 4+1 dhe 8+1 të licensuar
2. Drejtor i Hartimit të Projekteve, Monitorimit të Investimeve dhe të Shërbimeve Publike
3. Koordinator i të Drejtës për Informim
4. Përfaqësues të stafit të bashkisë

Takimi hapet nga Drejtori i Shërbimeve Publike në Bashki z. Arben Manoku

Arben Manoku – përvendetje dhe faleminderit që i jeni përgjigjur kerkësës së bashkisë për realizimin e këtij takimi. Ky takim i sotëm organizohet me qëllim marrjen e mendmit tuaj lidhur mbi shërbimin taksi 4+1 dhe 8+1 që ju ofroni për komitetin e qytetit. Mbështetur në ligjin 139/2015 për Pushtetin Vendor, ligjet për transportin rrugor rregullave dhe udhëzimeve të shumta nga Ministrai e Punëve Publike dhe transtportit për përcaktimin e kushteve të vecanta në transportin rrugor të udhëtareve si dhe Udhëzimeve lidhur mbi "Modelet e licencave, autorizimeve apo certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor" udhëzimit "Për përcaktimin e numrit të autoveturave taksi, si dhe Udhëzimit përpërcaktimin e kritereve dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor" ne kërkojmë sot nga ju marrjen e mendimit tuaj lidhur mbi disa ndryshime të cilat kërkojmë ti kalojmë në Këshill Bashkiak i cili padiskutim do të kërkojë një takim tjetër me ju në një dëgjesë tjetër publike.

Ajo që ne kërkojmë ka të bëjë lidhur mbi disa ndryshime të cilat ju prekin në mënyrë të drejtërdrejtë dhe kanë të bëjnë me:

- Numrin e licencave për automjetet e shërbimit taksi 4+1 për Bashkinë Patos të jetë 43 automjete (1 automjet për cdo 1'000 banorë) .
- Raportin e licencimit të taksive 4+1 me licencat 8+1 të jetë për çdo 5 mjete taksi, 4+1 licencohej 1 mjet taksi 8+1 (20 %), 8 mjete.
- Vjetërsia e mjeteve që do të licencohej për herë të parë dhe atyre që do të rilicensohen pranë Bashkisë Patos për shërbimin taksi 4+1 dhe 8+1, të jetë brenda 15 viteve nga data e aplikimit per licensim.
- Ngjyra e mjeteve te sherbimit taksi 4+1 do të jetë ngjyra e bardhë.
- Licencimi i subjekteve aplikues që do të operojnë në shërbimin taksi 4+1 dhe 8+1 do të krijohet mbi bazën e shqyrimit korrekt dhe transparent të dokumentacionit të paraqitur sipas kërkesave të ligjit brenda afatit 30 (tridhet) ditë kalendare nga data e aplikimit dhe subjekti merr pergjigjen nese ka fituar te drejten e licensimit.

Arben Manoku – Këto janë të gjitha ndryshimet për të citlat ne kërkojmë ti diskutojmë me ju me qëllim që të gjitha propozimet tuaja ti pasqyrojmë në projektvendimin që do të kërkoj vendim nga Këshilli.

Luan Zotaj – unë kam investuar në makinën time dhe ndryshimi i ngjyrës është kosto për mua.

Arben Shpërdheja – ngjyra e bardhë për taksitë ka që në vitin 2008 që është përcaktuar me vendim të Këshillit Bashkiak.

Arben Manoku – Qëllimi jonë nuk është që në të bëjmë ndryshimin e ngjyrës së automjetit por taksitë e Patosit por duhet të unifikohen në një ngjyrë të cilën ju vet do ta përcaktoni me qëllim që të dallojnë me taksitë e Fierit apo të bashkive të tjera. Nëse ju doni që të vendosni një ngjyrë tjetër përvec ngjyrës së bardhë hajde ta diskutojmë, cfarë propozoni ju. Por ajo që mua më shqetëson më shumë dhe që në gjykimin tim është më e rëndësishme për tu diskutuar është një pjesë e ligjit e cila kërkon përcaktimin e moshës së automjetit.

Luan Zotaj – për pjësën e ngjyrvës nuk e kemi shumë problem ndërsa lidhur mbi vjetërsinë e makinës ne kërkojmë që të shikohet viti i prodhimit të automjetit pasi mjeti përpëra se të dalë në qarkullim i bëhet një akt-vlerësimi dhe kur unë e kaloj kontrollin teknik për automjetin përsë të vendoset ky kusht për vitin e prodhimit?

Arben Manoku – është edhe një pjesë në ligj cila ka të përcaktuar vlerësimin e referencës. Ju cfarë propozoni pasi pa afat viti prodhimi të mjetit nuk mund të veprojmë për dhënie të lishencës taksi. Jemi të detyruar që së bashku të vendosim një afat.

Luan Zotaj – pas dy vjetësh mjeti im mbush moshën për qarkullim sipas jush dhe unë nuk mund të blej një makinë të re edhe pse mjeti e kalon në kontroll teknik ne keto kushte unë nuk mund të rinovojojë licensën?

Malo Muskaj – në momentin që mua më mbaron lishenca do të bëhet rinovimi i saj?

Arben Manoku – sigurisht që po

Luan Zotaj – Ministria e transportit nxjerr akt vlerësimi për automjetin dhe pa atë ne nuk mund të punojmë

Arben Manoku – akti i vlerësimit është taksative dhe ne nuk jemi duke diskutuar këtë pjesë por jemi duke diskutuar vjetërsinë e automjetit.

Luan Zotaj – mjetet janë të viti 2002 dhe ne jemi 15 taksist që kemi mjete të këtij viti prodhimi cfarë do te bëhet me ne do të mbetemi pa punë pasi jo të gjithë mund ta kenë mundësinë financiare për të blerë një mjet të ri.

Helion Bregu – hajde se po sakrifikojmë për të marrë një makinë të re sic e kërkoni ju por ne punojmë me bleta fikse dhe është tepër e vështirë pasi kemi konkurencë të fortë me taksitë e pa licensuara që punojnë me targa të bardha.

Arben Manoku – bashkia është autoriteti i cili jep lisencat për subjektet taksi por nuk mund të verifikojmë në cdo kohë dhe moment se cili subjekt ushtron veprimtari të paligjshme pa na sinjalizuar ju se cilat targa ju konkurojnë në mënyrë të paligjshme

Luan Zotaj – në emër të kolegëve kërkojmë të na përcaktohet vendi i punës për taksitë

Helion Bregu – në vendqëndrimin aktual të bëhet një xhep për qëndrimin e taksove

Arben Manoku – këto që po më thoni nuk janë objekt i këtij takimi ndaj do tju sygjeroja që ju së bashku të bëni një kërkesë pranë bashkisë lidhur mbi parkimin, vendqëndrimi apo cfarëdo lloji tjetër problemi që keni me qëllim që të bëjmë delegimin e problematikave tuaja. Nëse nuk e ngrini ju zërin kush do ta bëjë? Por unë do të kërkova nga ju një afat për moshën e automjetit

Viktor Simoni – në emër të kolegëve kërkoj nga ju të rishikohet afati i moshës së përdorimit të automjeteve

Luan Zotaj – ju mund të bëni shumë më shumë për ne dhe kërkojmë të rishikohet venqëndrimi jonë.

Gentian Banaj – ne hasim shumë probleme me policinë e Fierit lidhur mbi venqëndrimin tonë në Bashkinë Fier pasi shërbimi që ofrojmë është brenda Qarkut.

Arben Manoku – kjo është e përcaktuar në ligj për vendqëndrimin në qytete. Në kërkesën që do ti adresoni bashkisë shënoheni edhe këtë pikë që të kemi mundësi për ta diskutuar me Kryetaren.

Herion Bregu – ligjin e dimë mjaft mirë që e ka të parshikuar këtë gjë por nëse do të gjendet një marrëveshje

Arben Manoku – padiskutim që cdo kërkrkesë e juaja do të diskutohet me Kryetaren për ju duhet të zyrtarizoni kërkesën tuaj në bashki. Ndonjë sygjerim lidhur mbi vitin e prodhimit të mjetit pasi pa afat nuk mund të veprojmë për dhënie të lishencës taksi.

Arben Manoku - M.q.se nuk kemi një marrëveshje lidhur mbi këtë pikë atëherë do të jemi të detyruar të mblidhem i edhe një herë tjetër për ta diskutuar. Edhe një herë ju falenderoj për prezencën tuaq.

**Koordinator
Për Konsultimin Publik
Suzana Hysenaj**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS

Koordinator i Konsultimit Publik

“DISKUTIMI I PROCEDURËS PËR LICENCIMIN DHE RILJENCIMIN TË SHËRBIMIT TAKSI 4+1 DHE 8+1 NË BASHKINË PATOS”
Listë Prezencë për pjesëmarrje në degjeshën me temë:

| Nr | Emër | Mbiemër | Bashkia /Njësia | Subjekti Taksi NIPT | Nr. Kontakti | Firma |
|----|-----------------|---------------|--------------------------|------------------------|-----------------------------|------------|
| 1 | Herion BREGU | Patos | K72730403K | 0694255397 | H/B | |
| 2 | VIKTOR SIMONI | PATOS | 15515151515 | 0691331208 | | |
| 3 | Perleun Shuhaj | PATOS | 0328054126 | 0694293216 | | |
| 4 | Gentjan Boçaj | PATOS | 1828284056 | 0675406112 | | |
| 5 | Zeljana Mysemy | B. Patos | | | Koord. fonda/ku. 0691031460 | |
| 6 | Ollbine Djemini | B. Patos | | | Koord. fonda/ku. 0691031460 | |
| 7 | Morina Shadrimi | B. Patos | | | Specialiste NJE | 0692996833 |
| 8 | Gjermi Kastri | B. Patos | | | | |
| 9 | M.A.O MOSKAJ | POTOS | 1825244034 | 068468208 | | |
| 10 | Auben Manoku | Bashkia Patos | Drejtori: 5 herbineve | 0697538357 | | |
| 11 | Jaber Hysenbegu | B - Patos | | | | |
| 12 | | | | | | |

Në zbatim të Ligjit Nr.9837, datë 10.3.2008 “Për Mbrojtjen E Të Dhënave Personale”, Nemi 10 “Përpunimi për kërkime shikencore dhe statistikore” I të dhënave personale, të mbledhura përfarët qëllimi, mund të përpunohen në tej vetën për qellime shikencore ose statistikore, duke siguruar se nuk janë përpunuari, për të marrë masa ose vendime për një individ. Përpunimi i të dhënave personale lejohet të përdoren vetën për qellime gazetare, literaturë ose artistike. Përfashohet nga zbatimi i neneve 5, 6, 7, 8, 12, 18, 21 e 28 të këtij ligji, vetëm nëse mbrojja e të dhënave personale, sipas këtyre dispozitive, pengon ushtrimin e së drejtës së lirisë së shprehjes